



Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete,
Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e
Agjencisë kundër Korrupsionit



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. 'Rexhep Luci'. 10/5
Prishtinë, 10 000, Kosovë
Ueb-site: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 227 944

Data: 10 Qershor 2016

Nga: Grupi për Studime Juridike dhe Politike

REKOMANDIME

të dala nga diskutimi publik mbi "Ndryshimet e mundshme dhe / ose të nevojshme mbi legjislacionin që rregullon fushën e sistemit të drejtësisë" (mbajtur më datë 1 Qershor 2016)

1. Hyrje

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit në bashkëpunim me Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) mbajtën diskutimin publik lidhur me ndryshimet e mundshme/ të nevojshme mbi legjislacionin që rregullon fushën e sistemit të drejtësisë. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi i kërkesave të ndryshme të propozuara nga institucionet e drejtësisë si dhe mbledhja e propozimeve nga akterë të ndryshëm, të cilat do të mundësonin amandamentimin sa më të plotë të ligjeve të fushës së sistemit të drejtësisë. Pjesëmarrës në këtë diskutim, përveç anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, ishin përfaqësues të KGJK-së, KPK-së, ZPD-së, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, institucioneve ndërkombëtare, përfaqësues të ambasadave në Kosovë, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të institucioneve tjera të zbatimit të ligjit, si dhe mediave. Në vijim kemi listuar një grup rekomandimesh gjithëpërfshirëse të dala nga diskutimi publik. Duhet sqaruar që komentet dhe rekomandimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike do të dorëzohen në një dokument të veçantë, dhe nuk janë përfshirë në këtë dokument.

2. Rekomandimet

Në vazhdim mund t'i gjeni rekomandimet e dala nga tryeza.

Rekomandimi 1

(Të përgjithshme)

- **Planifikimi i kohës së mjaftueshme** - Pjesëmarrësit përgjithësisht u pajtuan që ndryshimet e ardhshme në ligjet që rregullojnë fushën e sistemit të drejtësisë të mos bëhen me procedurë të përshpejtuar, por të ndjekin

procedurat e rregullta ligjvënëse me qëllim që ndryshimet e reja të mos procedohen nën presionin e kohës.

- **Analizimi paraprak** - Gjithashtu u kërkua që para fillimit të ndryshimeve të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse e gjendjes aktuale, pengesave të mundshme që mund të evitohen me ligj dhe fushave ku ka nevojë për ndryshime.
- **Përfshirje e gjerë e akterëve të ndryshëm** - Pjesëmarrësit rekomanduan që gjatë ndryshimeve të ardhshme të pakos ligjore të fushës së drejtësisë të ketë një përfshirje të gjerë të të gjithë akterëve, si nga institucionet e drejtësisë e po ashtu edhe ekspertë të kësaj fushe. Gjithashtu u rekomandua që në grupet punuese në nivel qeveritar dhe parlamentar të ftohen të gjitha organizatat e shoqërisë civile që merren me çështjet e sundimit të ligjit.

Rekomandimi 2

(Konsolidimi i teksteve ligjore)

- Pjesëmarrësit rekomanduan që në ndryshimet e ardhshme ligjore në fushën e drejtësisë të bëhet konsolidimi i teksteve ligjore. Aktualisht secili institucion (KGJK dhe KPK) e ka të rregulluar fushën e saj me një ligj bazik dhe disa ligje për plotësim-ndryshim. Kjo e vështirëson zbatimin e ligjit, prandaj u propozua që tani e tutje të hartohet vetëm një ligj, duke shfuqizuar ligjet për plotësim-ndryshim.

Rekomandimi 3

(Masat Disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve)

- **Shlyerja e masës disiplinore** - Pjesëmarrësit rekomanduan që me ndryshimet ligjore të përfshihen edhe dispozita ligjore që mundësojnë shlyerjen e masës së shqiptuar disiplinore nga regjistrat pas kalimit të një

afati të caktuar kohor. Si shembull nuk u përmend ndonjë afat por u propozua analizimi i praktikave të shteteve të tjera.

- **Kategorizimi i shkeljeve** - Pjesëmarrësit rekomanduan që me ligj të rregullohet edhe kategorizimi i shkeljeve disiplinore dhe përskrimi i dënimit për secilen shkelje. Aktualisht kjo fushë rregullohet me rregulloret e KGJK-së dhe KPK-së, porse kërkohet që për shkak të rëndësisë që ka procedura disiplinore, e njëjta të rregullohet fillimisht me ligj.

Rekomandimi 4

(Afati i parashkrimit për rastet e hetimit nga ZPD)

- Pjesëmarrësit propozuan që të zgjatet afati i parashkrimit të lëndëve të ZPD-së për hetimin ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Afatet e përcaktuara të parashkrimit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2015 në formën e ligjit për plotësim-ndryshim, duke përfshirë edhe rastet e filluara para datës së hyrjes në fuqi të ligjit, ka bërë që një numër i madh i lëndëve të parashkruhen, duke përfunduar kështu me pamundësi të ndjekjes. Me zgjatjen e afatit ZPD shpreson që të ketë më shumë kohë për hetime edhe për vet faktin se Zyra e tyre ka mungesë të punonjësve përkundër numrit të madh të rasteve të paraqitura.

Rekomandimi 5

(Përfaqësimi i gjyqtarëve të gjykatave themelore në KGJK)

- U rekomandua që gjykatat themelore të kenë përfaqësim më të mirë në KGJK. Aktualisht 81 % e gjyqtarëve të Republikës së Kosovës janë të punësuar në instancë të parë (Gjykata Themelore). Përkundër saj, pjesa më e madhe e anëtarëve në KGJK janë gjyqtarë të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme. Në këtë aspekt, me ligj duhet të përcaktohet përfaqësimi i denjë i niveleve gjyqësore në KGJK, gjegjësisht përfaqësim më i madh i Gjykatave Themelore në këtë institucion kushtetues.

Rekomandimi 6

(Ndryshimi i procedurave për përzgjedhjen e gjyqtarëve porotë)

- Rekomandimi i gjashtë ka të bëjë me ndryshimin e procedurave për përzgjedhjen e gjyqtarëve porotë. Përgjithësisht u kërkua që të ndryshojnë procedurat e përzgjedhjes së tyre në favor të procedurave më të shkurtra dhe të shpejta. Kjo u arsyetua me procedurat e tejzgjatura të përzgjedhjes së gjyqtarëve porotë dhe rrjedhimisht edhe me mungesë të shpeshtë të tyre, përkundër nevojës si në konteste familjare dhe të tjera.

Rekomandimi 7

(Imuniteti i gjyqtarëve)

- Përkundër që me Kushtetutë dhe ligj nuk është përcaktuar çështja e imunitetit të gjyqtarëve, nuk është përcaktuar procedura e marrjes së imunitetit. Prandaj, në tryezë u rekomandua që me ligj të përcaktohet edhe mënyra e marrjes së imunitetit. Diçka e tillë duhet të rregullohet me dispozita ligjore dhe jo akte dytësore siç janë rregulloret e brendshme të KGJK-së.

Rekomandimi 8

(Rritja e kompetencave të kryetarëve të gjykatave themelore)

- Rekomandimi i radhës ka të bëjë me rritjen e kompetencave për gjyqtarët e gjykatave themelore. Pjesëmarrësit propozuan që me ndryshimet e ardhshme, kryetarëve të gjykatave themelore t'u shtohet edhe kompetenca lidhur me prokurimin dhe financat. Përmes subsidimit të këtyre dy fushave në kompetencë të gjykatave themelore, mundësohet plotësimi më efikas dhe në kohë më të shpejtë i nevojave të gjykatave për ushtrimin e detyrave. Mbi të gjitha, secila gjykatë do të ishte përgjegjëse për financat e veta dhe rrjedhimisht do të kishte planifikim më të mirë të buxhetit vjetor për secilën gjykatë.

Rekomandimi 9

(Amnistimi për vepra penale të kryera nga pakujdesia)

- Në tryezë u rekomandua që gjyqtarët e dënuar për vepra penale të dënueshme deri në gjashtë (6) muaj dhe të kryera nga pakujdesia të mos shkarkohen me automatizëm, por të amnistohen për ato vepra. Kjo për faktin se është vështirë të gjendet një zëvendësim për një gjyqtar me përvojë shumëvjeçare dhe në të cilin është investuar paraprakisht. Shkarkimi i tyre për shkak të kryerjes së këtyre veprave penale nga pakujdesia do të paraqiste humbje për sistemin gjyqësor.

Rekomandimi 10

(Çështja e mandatit fillestar për gjyqtarë dhe trajnimet për gjyqtarë/prokurorë)

- Pjesëmarrësit ngritën problemin e rregullimit të emërimit dhe ngritjes në pozitë të gjyqtarëve në sistemin e drejtësisë. Aktualisht kjo fushë rregullohet me një sërë ligjesh siç është ai për KGJK-në dhe IGJK-në (së shpejti *Ligji për Akademinë*).

Ka një sërë kompetencash të shpërndarë në institucione të ndryshme dhe si pasojë shprehet me konfuzion në përgjegjësitë e institucioneve për të nxjerrë akte nënligjore. Një rast shkollor është çështja e vlerësimit të gjyqtarëve të sapoemëruar. Përderisa dihet se akademia mban trajnimin për gjyqtarë të sapoemëruar, ligji për KGJK-në dhe Projektligji për Akademi flasin vetëm për vlerësimin, duke mos specifikuar më tej se cili institucion e bën atë vlerësim. Pjesëmarrësit rekomanduan që e gjithë çështja e trajnimeve fillestare, vlerësimit dhe trajnimet e vazhdueshme të rregullohen me një ligj (*Ligji për Akademinë*) dhe dispozitat në ligjet tjera që i referohen kësaj fushe të shfuqizohen. Momenti më adekuat për t'i bërë këto ndryshime është tani, kur Projektligji për Akademinë e Drejtësisë është duke u shqyrtuar në Kuvend dhe kur pritet që së shpejti të bëhen ndryshime të sërishme në legjislationin e fushës së drejtësisë.

Rekomandimi 11

(Zgjatja e afatit të parashkrimit për rastet e ZPD-së)

- Pjesëmarrësit rekomanduan që afati i parashkrimit për rastet në kompetencë të ZPD-së të zgjaten. Kjo për faktin se ZPD në ndryshimet ligjore të vitit 2015 është ballafaquar me afate të shkurtuara të parashkrimit dhe që ka rezultuar me numër të madh të rasteve nën hetim të cilat janë detyruar të hidhen poshtë si të parashkruara. Pjesëmarrësit, por edhe zyra e ZPD-së, kanë kërkuar që këto afate të zgjaten edhe për vet faktin se kjo zyrë ka personel të pamjaftueshëm dhe numër të madh të rasteve me ç'rast rrjedhimisht edhe vështirësohet kryerja e hetimeve brenda periudhës së përcaktuar kohore.

Rekomandimi 12

*(Pavarësi dhe Ligj të veçantë për ZPD-në;
afate kufizuese të hetimit; publikimi i vendimeve)*

- **Pavarësia dhe Ligj i veçantë për ZPD** - Pjesëmarrësit në tryezë rekomanduan që Zyra e Prokurorit Disiplinor të pavarësohet dhe njëherësh të nxjerrët një ligj i veçantë për ZPD-në. Sipas pjesëmarrësve, një ZPD më vete, me Kryetarin dhe strukturën e saj të pavarur nga institucionet e tjera të

sistemit të drejtësisë, do të ndikoj në punën sa më objektive të kësaj zyre. Po ashtu pjesëmarrësit vlerësuan të arsyeshme që mandati i ZPD-së të rregullohet përfundimisht me një ligj të veçantë që do të përcaktonte saktë statusin juridik të zyrës, kompetencat dhe çështjet tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të zyrës.

- **Afatet kufizuese të hetimit** - Pjesëmarrësit po ashtu rekomanduan që procedura hetimore të kufizohet në kohë. Si shembull u përmend afati i hetimit në instancë të parë në jo më shumë se 6 muaj dhe instanca e dytë të përfundoj në jo më shumë se 3 muaj, pra që i gjithë hetimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të mos zgjasë më shumë se 9 muaj.
- **Publikimi i vendimeve**– Gjatë diskutimit po ashtu u rekomandua që vendimet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të publikohen vetëm kur vendimi të ketë marrë formën e prerë (të plotfuqishme). Qëllimi i këtij rekomandimi është që gjyqtarët dhe prokurorët (*dhe rrjedhimisht sistemi i drejtësisë*) të mos bien në një dritë të keqe kur ende nuk ka një vendim përfundimtar.

Rekomandimi 13

(Unifikimi i standardeve në ligjin për KGJK-në dhe KPK-në; Përvojë minimale për anëtarë të KGJK/KPK-së; përfaqësimi i OAK-së)

- **Unifikimi i standardeve** - Në tryezë u rekomandua që të standardizohen kriteret për anëtarësim në mes të KGJK-së dhe KPK-së. Përderisa Kryeprokurori i shtetit ex-officio është anëtar i KPK-së, diçka e tillë nuk ndodhë me Kryetarin e Gjykatës Supreme. Do të duhej që çështjet e njëjta në ligje të rregullohen njëjtë.
- **Përvojë minimale** – Pjesëmarrësit vunë në theks mungesën e një dispozite ligjore që do të vendoste një prag të përvojës minimale para zgjedhjes si anëtarë në KGJK/KPK. Duke parë rëndësinë që kanë këto institucione në ruajtjen dhe zhvillimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, anëtarët duhet të jenë njerëz me përvojë pune që kanë fituar njohuri me sistemin e drejtësisë dhe të metat, pengesat etj. me të cilat ballafaqohet gjyqësori/prokuroria. Prandaj u rekomandua që me ligj (*për KGJK-në dhe KPK-në*) të kërkohet edhe përvoja minimale e punës për t`u bërë anëtarë në KGJK/KPK.
- **Përfaqësimi i OAK në KGJK/KPK**–Në tryezë u rekomandua që Oda e Avokatëve të Kosovës duhet patjetër të përfaqësohet në KGJK/KPK. Me ligj duhet të përcaktohet saktë mënyra e zgjedhjes së anëtarit në këto dy institucione dhe të largohen të gjitha pengesat ligjore që e bëjnë anëtarësimin në KGJK/KPK të pafavorshme.

Rekomandimi 14

(Rishikimi i çështjes së emërimit)

- Pjesëmarrësit kërkuan që të rishikohet çështja e emërimit të gjyqtarëve dhe detyrimi për ndjekjen e trajnimeve fillestare. Përderisa një gjyqtar është emëruar, logjikisht dalim në përfundim se ai ka njohuri të themelta dhe nuk ka nevojë për trajnime fillestare të ofruara nga IGJK (*në të ardhmen Akademia e Drejtësisë*). Po ashtu edhe vlerësimi do të ishte i panevojshëm kur është bërë veçse emërimi.
Prandaj, u rekomandua që të rishikohet edhe çështja e emërimit të gjyqtarëve. U propozua që fillimisht kandidatët të ndjekin trajnimet fillestare për gjyqtarë dhe pastaj të bëhet vlerësimi i tyre dhe emërimi për gjyqtarë.

3. Rekomandime të tjera

Në vazhdim mund të gjeni një listë me rekomandime të tjera të propozuara në tryezë, që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndryshimet ligjore, por përgjithësisht me sistemin e drejtësisë:

1. U propozua që me ndryshimet e ardhshme të mos kufizohen vetëm në legjislacionin lidhur me KGJK-në dhe KPK-në, por gjithashtu edhe ligjin për Prokurorinë Speciale dhe asaj të drejtësisë penale (*Kodi dhe Procedura Penale*). Po ashtu duhet të mënjanohet dyfishimi i kompetencave të njëjta për institucione të ndryshme.
2. U propozua që rigjykimi të lejohet vetëm një herë. Aktualisht Gjykata e Apelit mund të kthej rastet në rigjykim tek gjykatat themelore pa një kufizim të caktuar. U propozua që një rast të mund të kthehet më së shumti një herë në rigjykim dhe që pas ankesës së dytë (pas vendimit të marrë në rigjykim), Gjykata e Apelit të vendos për rastin. Kjo edhe është në pajtim të plotë me të drejtën themelore të gjykimit në kohë të arsyeshme.
3. Po ashtu duhet të rishikohet çështja e vlerësimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të kryetarëve të gjykatave themelore. Kushtet e njëjta të vlerësimit që zbatohen ndaj gjyqtarëve të gjykatave themelore duhet të zbatohen edhe ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe ndaj kryetarëve të gjykatave themelore. Duhet të gjendet një formë që siguron vlerësimin real të këtyre kategorive të gjyqtarëve.